



Përkujdesje fëmijësh si plotësim shkolle - Schulergängende Kinderbetreuung

Informacione të shkurtëra për prindër mbi oferta të mundëshme

Familje ditore (Tagesfamilie)

Në një familje ditore për fëmijën tuaj ka përkujdesje njëloj si në shtëpi dhe shpesh ka vëllezër e motra ditore për të luajtur dhe për të pasur kënaqësi. Ju dhe familja ditore përcaktoni orarët e përkujdesjes për fëmijën tuaj sipas dëshirave dhe nevojave vetjake.

Tavolinë dreke (Mittagstisch)

Kjo oferte i ofron fëmijës suaj mundësinë të drekojë së bashku dhe të kalojë kohën e lirë gjatë drekës bashkë me fëmijët e tjerë. Tavolina e drekës mund të shfritëzohet, shfritëzohet çdo ditë, nga e Hëna deri në të Premte, ose në ditë të veçanta.

Strehë ditore për fëmijë/Klub nxënësish (Schülerhort/Schülerclub)

Strehimet ditore për fëmijë janë vende të cilat ofrojnë përkujdesje profesionale për fëmijë kopshtesh dhe shkollash. Fëmijët dhe personat që përkujdesen për ta e organizojnë kohën pas shkollës në më të shumtën në grupe me rreth njëzet fëmijë të moshave të përziara. Përkujdesja mund të jetë gjithëditore, nga e Hëna deri në të Premten, ose në ditë të veçanta si dhe sipas zgjedhjes: mëngjeseve, drekave apo mbasditeve.

Shkolla ditore/Kopshte fëmijësh ditore (Tagesschule/Tageskindergarten)

Të gjithë fëmijët janë nga e Hëna deri në të Premte, që prej fillimit të mësimin e deri në fund të tij (përfshirë dhe përkujdesjen në orarin e drekës) në shkollën apo në kopshtin ditor. Oraret para fillimit dhe pas mbarimit të mësimin mund të shfrytëzohen në mënyrë individuale.